



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:160125

Datë: 14.12.2023

Numri i dokumentit: 05066200

P.nr. 799/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas gjyqtarit të vetëm gjykues Veton Ademaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kaltrina Rexhepi – Imami, në lëndën penale ndaj të pandehurit M. Sh, për shkak të veprës penale *organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm* nga neni 294 par.2, të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Përgjithshme PP/II.nr. 1487/19, të datës 30.10.2020, si dhe Marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë PP/II.nr.1487/19 të datës 12.10.2020, në seancën publike për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, të mbajtur me datë 05.12.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit L. H, të pandehurit M. Sh, mbrojtësit të tij av. B. L, caktuar sipas detyrës zyrtare, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 14.12.2023, e përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

M. (B.) SH, i lindur me datë ..., në fsh. R. K. P, ku edhe banon, i lindur nga babai B, dhe nëna Gj, e vajzërisë B, i identifikuar në bazë të numrit personal....., i gjendjes së mesme ekonomike, i papunë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse

Më parë e gjerë me datë 28.06.2019, rreth orës 21:30, në rr. ” ” në P, pikërisht në lokalin “ ...”, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, në kundërshtim me Ligjin për Ndalimin e Lojërave të Fatit (06/L-155), organizon lojëra të fatit, në atë mënyrë që natën kritike gjatë kontrollit që kanë bërë Policia e Kosovës dhe Inspektorati Komunal kanë konstatuar se i pandehuri në lokalin e lartcekur ushtron veprimtari të kundërligjshme dhe atë lojëra të fatit, ku ka gjetë dhe konfiskuar 58 tiketa të lojërave të fatit të printuara me datë 28.06.2019,

- me çka ka kryer veprën penale *organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm* nga neni 294 par. 2 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 7, 8, 38, 39 par.1. nën par 1.1, nenit 40 par. 1 nën par. 1.2, 42, 43, 44, nenit 294 par. 2 të KPRK-së si dhe neni 364 të KPP-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

DËNIM ME BURGIM, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej 3000 (tremijë euro) €, e të cilin dënim i pandehuri është i obliguar të e paguajë në afat prej 3 (tre) muajve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do të i zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të llogaritet 20 (njëzetë euro) €.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzetë euro) €, në afat prej 30(tridhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I pandehuri obligohet që në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 20 (njëzetë euro) €, në afat prej 30(tridhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të pandehurit konform 277 të KPPRK-së, i konfiskohen:

1. Një (1) kartëmonedhë prej 50,00 euro me nr. serik
2. Një (1)kartëmonedhë prej 20,00 euro me nr. serik
3. Një(1) kartëmonedhë prej 20,00 euro me nr. serik.....,
4. Një (1)kartëmonedhë prej 20,00 euro me nr. serik.....,
5. Një (1) kartëmonedhë prej 10,00 euro me nr. serik.....,
- 6.Një (1) kartëmonedhë prej 10,00 euro me nr. serik.....,
- 7.Një (1) kartëmonedhë prej 10,00 euro me nr. serik.....,
8. Një (1) kartëmonedhë prej 10,00 euro me nr. serik.....,
9. Një (1) kartëmonedhë prej 10,00 euro me nr. serik
10. Një (1) kartëmonedhë prej 10,00 euro me nr. serik.....,
11. Katër (4) Bankënota prej 2 euro = 8 euro pa nr. serik....,
- 12.Njëzetë e katër (24) Bankënota prej 1 euro= 24 euro pa nr. serik
13. Njëzetë e katër (24) Bankënota prej 0,50 euro= 12 euro pa nr. serik
14. Tridhjetë e dy (32) Bankënota prej 0.20 euro=6.40 euro pa nr. serik
- 15.Njëzetë e katër (24) Bankënota prej 0,10 euro= 2.40 euro pa nr. serik
16. Pesë (5) Bankënota prej 0.05 euro=0. 25 euro pa nr. serik
- 17.Shtëpizë Kompjuteri Dell me nr. serik
18. Shtëpizë Kompjuteri Dell me nr. serik....
- 19.TV-Samsung me nr. serik
20. TV- Samsung me nr. serik
21. TV-Samsung me nr. serik
- 22.TV-Samsung me nr. serik

- 23.DVR tipi D linj me nr. serik.....
- 24.Printer BIXOLON me nr. serik
- 25.Printer Epson me nr. serik
- 26.Telefon Nokia 105 me nr. emei.....
- 27.58 Tiketa të plotësuara të basteve
- 28.Faturë nr.0003261 datë 06.04.2019, emri i blerësit shumë 85.40 euro
- 29.Fatura nr. 0007100 datë 28.06.2019, emri i blerësit A. shuma 24.80 euro
- 30.Kontrata
- 31.Kontrata me IPKO
- 32.Kontrata me Kujtesën
- 33.Marrëveshja për bashkëpunim me lotari mes Kosovës
- 34.Çertifikata e regjistrimit I. K. Sh. p .k.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti për krime të përgjithshme me datë 30.10.2020 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr. 1487/19, ndaj të pandehurit M. Sh , për shkak të veprës penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par. 2 të KPRK-së, ashtu që bashkë me aktakuzë në gjykatë është bashkangjitur edhe marrëveshja për pranimin e fajësisë PP/II.nr.1487/19, e datës 12.10.2020.

Gjykata me datë 05.12.2023, ka mbajtur seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, ku prezent ka qenë prokurori i shtetit L. H, i pandehuri M. Sh, së bashku me mbrojtësin e tij av. B. L, caktuar sipas detyrës zyrtare,

Në seancën e datës 05.12.2023 ku është shqyrtuar marrëveshja mbi pranimin e fajësisë, i pandehuri deklaroj se e pranon marrëveshjen e arritur në Prokurori dhe i qëndron prapa asaj marrëveshje dhe pranimit të fajësisë sipas asaj marrëveshje.

Mbrojtësi i pandehurit M. Sh., av. B. L. ka deklaruar se qëndron pranë marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, pasi që e njëjta është e lidhur me vullnetin pa presion dhe pas konsultimit me të si mbrojtës.

Prokurori deklaroi që qëndron pranë marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ashtu siç gjendet në shkresa të lëndës.

Me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, sipas nenit 230 par 20 të KPP-së, gjykata fillimisht ka përcaktuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën e veprës penale, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe se nuk ka qenë i detyruar, apo shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë se pranimi i fajësisë ka mbështetje në fakte dhe prova materiale të cilat paraqiten në aktakuzë, andaj ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe në pajtim me marrëveshjen, gjykata të pandehurit i ka shqyrtuar dënimin e lartcekur, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata për të pandehurin, mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 par.1, të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori faktin se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, si dhe pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes, ndërsa rrethana rënduese ndaj të njëjtit nuk gjeti.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit, është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikojë edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë, që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 449 par.1 dhe 2, nën par. 2.6, të KPPRK-së, gjykata ka obliguar të pandehurin që në emër të shpenzimeve për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzetë euro) €.

Konform nenit 449 par 2 nën par. 2.9 të KPPRK-së dhe nenin 36 par.1, 2, 3, nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, e obligoi në pagesën e taksës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata e përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për Krime të Përgjithshme
P.nr.799/20, dt. 14.12.2023**

**Bashkëpunëtore profesionale
Kaltrina Rexhepi - Imami**

**Gjyqtari
Veton Ademaj**

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.